

## RELACION TEKNIK

### • Te pergjithshme

Bazuar ne detyren e projektimit te dhena nga Bashkia Shkoder per Sistemim-Asfaltim rrugë të brëndshme " Samrisht i Vjetër", nga ana jone si shoqeri projektimi filloi menjehere pune per hartimin e projekt-zbatimit.

Ky bllok rruges ndodhet ne jug-perendim te qytetit te Shkodres, duke perfshire rruget e brendshme te fshatit Samrisht.

Gjithsej per tu trajtuar ne kete projekt jane 5 akse rrugore, me nje gjatesi totale prej 1 671 ml.


Ndertimi i ketij segmenti rrugor do te lehtesoje ne menyre te ndjeshme levizjen e banoreve te fshatit Samrisht.

Rruget e perfshira ne detyre projektimi me emertimin dhe gjatesite perkatese jane si me poshte vijon:

- Aksi 1 me gjatësi 761.3 ml
- Aksi 2 me gjatësi 456.4 ml
- Aksi 3 me gjatësi 226.5 ml
- Aksi 4 me gjatësi 180.7 ml
- Aksi 5 me gjatësi 46.2 ml

Bashkia Shkoder ka kerkuar qe Projekti i Zbatimit Perfundimtar te ndahet ne dy faza, ne Fazen e Pare te perfshihen ato segmente rrugore me gjatesi te reduktuara te cilat jane brenda vleres se parashikuar ne Buxhetin e Bashkise Shkoder brenda vitit 2019, ndersa ne Fazen e Dyte te perfshihet pjesa tjeter e segmenteve rrugore qe tejkalon Buxhetin e Bashkise Shkoder per vitin 2019.

Per segmentet qe nuk financohet ne buxhetin e 2019, nga ana e Bashkise Shkoder do te shikohet mundesia e financimit te tyre ne nje faze tjeter.



Horografia

## • Pershkrimi i Gjendjes se Trasese Ekzistuese

Segmentet rrugore te cilat kane një gjatësi totale rreth 1 671 m kalojne mes ndërtimeve 1-2 katëshe në zonën e Njësisë Administrative Samrisht.

Akset e ketij blloku rrugesh kane nje gjeresi te ndryshueshme 2.5-4m.

Gjendja ekzistuese e trupit te rrugeve eshte ne kushte relativisht te keqija, me shtresa rrugore te degraduara, pergjithesisht me nje mbulesa cakelli ose zhavorri.

Kanalet anesore te ketyre rrugeve pothuajse jane zhdukur me kalimin e viteve si rezultat i mungeses se mirembajtjes se duhur, gje e cila e ben te pamundur drenazhimin e ujrave siperfaqesor duke ndikuar edhe me shume ne demtimin e trupit te rruges.

Gjate hartimit te ketij projekti eshte menduar qe ne masen me te madhe te mundshme te shfrytezohet traseja ekzistuese, ne kete menyre nuk do te krijonim probleme me shpronesimet ne rrugen e fshatit Samrisht.

Keto rruge perfaqesojne nje trase te deformuar si dhe vepra arti pothuajse jashte funksioni, te cilat nuk sigurojne mbrojtjen e trasese, duke mos krijuar mundesine e drenimit te ujrave siperfaqesore.

Trasete e ketyre segmenteve nderpresin kanale kullues prandaj dhe eshte parashikuar ndertimi i tombinove te reja me diameter 600 mm dhe 1000mm si dhe pastrimi e riprofilimi i kanaleve ekzistues.

Ne keto segmente do te kryehen punime asfaltike, do te ndertohen tombino dhe do parashikohen ndërtimi i dy bankinave ne anët e saj. Bankinat, do të shërbejnë si distance sigurie mes korsisë së lëvizjes dhe kanaleve anësore. Rruget përgjatë gjithë gjatësisë së tyre do kenë pjerrësi tërthore gjë e cila mundëson drenazhimin e ujërave sipërfaqësore direkt aty ku ka kanale anësore ekzistuese.



*Foto te gjendjes ekzistuese*

## • Pershkrimi i Projekt-Zbatimit

Ashtu sic u permend edhe me siper ne zonat e banuara eshte parashikuar qe akset e rrugeve te reja te vendosen mbi akset e rrugeve ekzistuese, nje zgjidhje e tille eshte dhene per te mos krijuar probleme me shpronsimet e tokave. Si rrjedhoje edhe per rrezet e kthesave pergjithsisht jane aplikuar ato ekzistueset, por megjithate ne disa raste vec shfrytezimit te trasese ekzistuese eshte nderhyre edhe per permiresimin e rrezeve te kthesave.

Keto akse pergjate gjithë gjatesise se tyre kane pjerresi te vogla mesatarisht midis 0.02-1.45%.

Pothuajse ne te gjithë gjatesine e rruges per shkak te shtresave ekzistuese te demtuara eshte parashikuar nje germim kasonete mesatarisht nga 30-65cm.

Ne projekt-zbatimin e ketij objekti eshte parashikuar nje rikonstrukcion total i trupit te rruges ne te gjithë gjatesine e saj.

**Per Aksin Nr. 1** gjeresia totale e trupit te rruges, ne pjesen me te madhe eshte 4m, me gjeresi asfalti 3 m dhe bankina stabilizanti 2x0.5m, dhe kur bankina ne njerin krahe konturohet me bordure 20x30cm gjeresia e asfaltit shkon ne 3.5m.

Nga Km 0+284 deri ne Km 0+360 ne te dyja krahët eshte parshikuar te ndertohen mure mbajtese buto betoni C7/10 me lartesi h=1m.

Pergjate rruges jane parashikuar pastrimi dhe riprofilimi i kanaleve kullues te dheut dhe ne pjesen e fundit eshte parshikuar ndertimi i nje kanali te ri.

**Per Aksin Nr. 2** gjeresia totale e trupit te rruges, deri ne Km 0+175 eshte 4m, me gjeresi asfalti 3.5 m, bankina stabilizanti 0.5m ne krahun e majte, dhe bordure 20x30cm ne krahun e djathte.

Pergjate rruges ne krahun e majte jane parashikuar pastrimi dhe riprofilimi i kanaleve kullues te dheut deri ne Km 0+190 dhe ne krahun tjeter eshte parshikuar ndertimi i nje kanali te ri. Kanal i ri eshte parshikuar eshe per krahun e majte nga Km 0+190 deri ne fund te rruges.

**Per Aksin Nr. 3** gjeresia totale e trupit te rruges, ne pjesen me te madhe eshte 4m, me gjeresi asfalti 3 m dhe bankina stabilizanti 2x0.5m, dhe kur bankina ne njerin krahe konturohet me bordure 20x30cm gjeresia e asfaltit shkon ne 3.5m.

Pergjate rruges ne krahun e majte eshte parshikuar kanal i ri dheu.

**Per Aksin Nr. 4** gjeresia totale e trupit te rruges, ne pjesen me te madhe eshte 4m, me gjeresi asfalti 3 m dhe bankina stabilizanti 2x0.5m.

Pergjate rruges eshte parashikuar ndertimi i kanaleve te rinj betoni C16/20 me permasa 0.5x0.5 dhe 0.4x0.4.

**Per Aksin Nr. 5** gjeresia totale e trupit te rruges, ne pjesen me te madhe eshte 4m, me gjeresi asfalti 3.5 m, bankin stabilizanti 0.5m ne krahun e majte, dhe bordure 20x30cm ne krahun e djathte.

Pergjate rruges eshte parashikuar parshikuar ndertimi i nje kanali te ri ne krahun e majte.


Per sa i perket shtresave rrugore eshte parashikuar kjo pakete:

- 3 cm asfalto-beton
- 5 cm binder
- 20 cm stabilizant (0-31.5mm)
- 30 cm material shkembor (cakell/zhavorr)


Ne projekt eshte parashikuar trajtimi i te gjitha siperfaqeve te intersektimeve me rrugen kryesore ne gjatesi 5m per secilen. Kjo nderhyrje eshte e domosdoshme per te mbrojtur rrugen kryesore. Volumet per ndertimin e tyre jane parashikuar ne preventivin perkates.

Paketa e shtresave e parashikuar ne degezime eshte:


- 3 cm asfalto-beton
- 5 cm binder
- 20 cm stabilizant (0-31.5mm)
- 30 cm material shkembor (cakell/zhavorr)




Profile Tip Aksi nr 1




*Profile Tip Aksi nr 1*




*Profil Tip Aksi nr 2*



Profil Tip Aksi nr 3



Profil Tip Aksi nr 4



*Profil Tip Aksi nr 5*

### • Mbi veprat e artit

Si vepra arti ne kete studim do te konsiderojme tombinot rrethore, si edhe muret mbajtes betoni.

Tombinot qe jane parashikuar ne studim per largimin e ujrave siperfaqesore te vendosura ne zonat depresive te rruges do te jene me diameter Ø600mm dhe Ø1000mm sipas rastit me portal+portal. Ato do te sherbejne per kalimin e ujit te kanaleve kullues permes rrugeve sekondare apo segmentit tone.

### • Sinjalistika rrugore

Persa i perket sinjalistikës rrugore nga ana jone eshte hartuar projekti i sinjalistikës vertikale dhe horizontale.

Me konkretisht ne te gjithë gjatësinë e rruges jane parashikuar vendosje te tabelave rrethore 40cm.

Ne te gjitha degezimet jane vendosur tabela "STOP" me permasa (A=60, B=20,D=50).

Ne afersi te shkolles eshte parashikuar vendosja e vijave te kalimit te kembesoreve shoqeruar me tabelen perkatese A=40. Gjithashtu per te paralajmëruar praninë e

shkolles eshte vendosur tabela perkatese trekendore  $A=60\text{cm}$  ne te dy drejtimet e levizjes.

Ne te dy anet e rruges eshte parashikuar vendosja e vizimit akrilik gjatesor me gjeresi  $12\text{cm}$ .

Ne te gjitha degezimet eshte parashikuar qe tabela "STOP" te shoqerohet me nje shirit te vazhduar horizontal me gjeresi  $0.5\text{m}$ , me qellim ndalimin e automjeteve qe te futen ne rrugen kryesore kur ata ndodhen ne brendesi te degezimit.

Megjithate bazuar edhe ne termat e references dhe mungeses se financimeve te nevojshme, nderhyrjet ne kete rruge jane minimale, per rrjedhoje ne te ardhmen mund te shikohet mundesia e nderhyrjeve me te plota.

*Ashtu sic eshte permendur edhe me lart, ne perputhje me vendimin e Bashkise Shkoder, punimet ndertimore te parashikuara ne kete projekt-zbatimi jane ndare sipas fazave perkatese te financimit.*

*Me poshte pershkruhen punimet ndertimore qe do te realizohen sipas fazave perkatese te financimit.*

## • Faza e Pare

**Gjate Fazes se Pare te Investimit me Vlere 18 313 389.66 me TVSH, perfshihen punimet rehabilituese per:**

- Aksin Nr. 1 ne km 0+000 deri km 0+620
- Aksin Nr. 3 ne km 0+000 deri km 0+065
- Aksin Nr. 5 ne km 0+000 deri km 0+046

Ne segmentet e mesiperme do te kryhen te gjitha punimet e nevojshme, te cilat jane te nevojshme teknikisht, per nje operim sa me te mire te rruges.

Keto punime jane si me poshte vijon:

- **Aksi Nr. 1**
  - Punime Germimi, km 0+000 deri km 0+620
  - Punime Mbushje, km 0+000 deri km 0+620
  - Punime Shtresash rrugore, km 0+000 deri km 0+620
  - Punime per veprat e vogla te artit ( kanale, tombino etj ) km 0+000 deri km 0+620
  - Punime per mure mbajtes, ne km 0+000 deri km 0+620

- Punime Sinjalistike, ne km 0+000 deri km 0+620
- **Aksi Nr. 3**
  - Punime Germimi, km 0+000 deri km 0+065
  - Punime Mbushje, km 0+000 deri km 0+065
  - Punime Shtresash rrugore, km 0+000 deri km 0+065
  - Punime Sinjalistike, ne km 0+000 deri km 0+065
- **Aksi Nr. 5**
  - Punime Germimi, km 0+000 deri km 0+046
  - Punime Mbushje, km 0+000 deri km 0+046
  - Punime Shtresash rrugore, km 0+000 deri km 0+046
  - Punime Sinjalistike, ne km 0+000 deri km 0+046

- **Faza e Dyte**

**Gjate Fazes se Dyte te Investimit me Vlere 22 269 534.51 me TVSH, perfshihen punimet rehabilituese per:**

- **Aksin Nr. 1 ne km 0+620 deri km 0+761**
- **Aksin Nr. 2 ne km 0+000 deri km 0+456**
- **Aksin Nr. 3 ne km 0+065 deri km 0+226**
- **Aksin Nr. 4 ne km 0+000 deri km 0+180**

Ne segmentet e mesiperme do te kryhen te gjitha punimet e nevojshme, te cilat jane te nevojshme teknikisht, per nje operim sa me te mire te rruges.

Keto punime jane si me poshte vijon:

- **Aksi Nr. 1**
  - Punime Germimi, km 0+620 deri km 0+761
  - Punime Mbushje, km 0+620 deri km 0+761
  - Punime Shtresash rrugore, km 0+620 deri km 0+761
  - Punime per veprat e vogla te artit ( kanale, tombino etj ) km 0+620 deri km 0+761
  - Punime Sinjalistike, ne km 0+620 deri km 0+761
- **Aksi Nr. 2**
  - Punime Germimi, km 0+000 deri km 0+456
  - Punime Mbushje, km 0+000 deri km 0+456
  - Punime Shtresash rrugore, km 0+000 deri km 0+456

- Punime per veprat e vogla te artit ( kanale, tombino etj ) km 0+000 deri km 0+456
- Punime Sinjalistike, ne km 0+000 deri km 0+456
- **Aksi Nr. 3**
  - Punime Germimi, km 0+065 deri km 0+226
  - Punime Mbushje, km 0+065 deri km 0+226
  - Punime Shtresash rrugore, km 0+065 deri km 0+226
  - Punime Sinjalistike, ne km 0+065 deri km 0+226
- **Aksi Nr. 4**
  - Punime Germimi, km 0+000 deri km 0+180
  - Punime Mbushje, km 0+000 deri km 0+180
  - Punime Shtresash rrugore, km 0+000 deri km 0+180
  - Punime per veprat e vogla te artit ( kanale, tombino etj ) km 0+000 deri km 0+180
  - Punime Sinjalistike, ne km 0+000 deri km 0+180

Bashkangjitur ketij raporti jane te gjitha materialet teknike si me poshte vijon:

- Vizatimet dhe Detajet Teknike
- Preventivi ( Preventivi Total, Preventivi Faza e Pare/ Preventivi Faza e Dyte) dhe Analizat e Cmimeve
- Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis VNM
- Specifikimet Teknike
- Grafiku i punimeve

**Drejtuesi Ligjor**

**Ing. Redi Struga**

